

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

ZHVILLIMI I FONDEVE PRIVATE TË PENSIONEVE NË SHQIPËRI - NJË
DOMOSDOSHMËRI E KOHËS

Msc. Ermelinda Satka¹
Arja Plaku²
Adriana Hasaj³

Abstrakt

Sistemi aktual i sigurimeve shoqërore në vendin tonë ka një të kaluar të zhvillimit dhe administrimit të tij, pasi një skemë e pensioneve publike në Shqipëri është vendosur që në vitin 1947 dhe më tej me ndryshimet ligjore është zhvilluar një skemë e plotë e sigurimeve shoqërore, duke qënë se pensioni është e ardhura kryesore gjatë periudhës kur individët nuk janë më të aftë për punë. Natyrisht, stabiliteti financiar dhe zhvillimi i sistemit të sigurimeve shoqërore në Shqipëri, ka qënë dhe mbetet i ndikuar nga fuqia ekonomike e vendit, stabiliteti makroekonomik, situata demografike, zhvillimet e tregut të punës, niveli i papunësisë, niveli i punësimit, i pagave, etj.

Zhvillimet dhe ndryshimet e tregut të kapitalit në vend gjatë viteve të fundit kanë tërhequr vëmendje të shtuar nga ana e individëve, por edhe e institucioneve financiare për alternativa të reja investimi dhe kursimi, të cilat mbartin reflektimet e tyre dhe në zhvillimin e sistemit të sigurimeve. Veçanërisht tregu i pensioneve vullnetare ka pasur rritje gjatë viteve të fundit, si në asete dhe në numër të anëtarëve në fond. Nisur nga ky fakt, qëllimi i këtij artikulli është të analizojë zhvillimin e pensioneve private vullnetare në vendin tonë, nëpërmjet njohjes së sistemit, rëndësisë, zbatueshmërisë, sfidave dhe problematikave që has, zhvillimit, rolit të kuadrit ligjor rregullator, si dhe shoqërive administruese, lidhur me zhvillimin e fondeve private të pensioneve.

Metodologjia e punimit bazohet në kuadrin teorik, duke ndërmarrë një shqyrtim të kornizave ligjore, të të dhënave dhe informacioneve zyrtare, artikujve, raporteve si dhe punimeve shkencore.

Konkluzionet fokusohen në drejtime të tilla si: mungesë informacioni dhe njohurish për skemat vullnetare, prania e ekonomisë informale pengon zgjerimin e skemës private, fondi i pensionit vullnetar i administruar nga shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar përjashtohet nga tatim-fitimi, duke u bërë mjaft tërheqëses për investime.

¹ Lektore, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Punës dhe politikës Sociale, e-mail: ermelinda-satka@hotmail.com

² ^b Studente, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Dega “Administrim dhe Politika Sociale”, e-mail: arja.plaku16@gmail.com

³ ^c Studente, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Dega “Administrim dhe Politika Sociale”, e-mail: adriana.hasaj10@gmail.com

Për të ardhmen rekomandohet: Domosdoshmëria dhe zhvillimi i fondeve private të pensioneve, duke i bërë ato të detyrueshme, evidentimi i nevojës së vendit për uljen e kostove dhe përmirësimin e ecurisë së investimeve në periudhë afatgjatë, ndërgjegjësimi i popullatës për të disiplinuar të ardhurat dhe për të kursyer në mënyrë që të kenë një të ardhme më të sigurtë.

***Fjalë kyçe:** sigurime shoqërore, fondi i pensioneve private vullnetare, pension, kursim, shoqëri administruese.*